

FJALA E DEPUTETIT ARBEN PËLLUMBI

E ENJTE 27 JANAR 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Meqenëse nismat e mia për ndryshime në ligjet për ushqimin dhe për shërbimet veterinare, që po shqyrtojmë sot, synojnë të njëjtin qëllim, lehtësimin e procedurave dhe praktikave, më lejoni që edhe në prezantimin e diskutimit ta bëjmë së bashku për të dyja projektligjet. Ndryshimet e sotme ligjore vijnë si një përgjigje për kërkesat e kahershme të biznesit dhe do të shërbejnë për përmirësimin e legjislacionit ekzistues me synim lehtësimin e klimës së bërjes biznes, dhe në mënyrë të veçantë për operatorët ekonomikë vendas, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike në import-eksport në fushën e ushqimit dhe produkteve blegtorale. Amendamentet e bëra në të dyja ligjet do të lehtësojnë shkëmbimin tregtar me vendet me të cilat qeveria shqiptare do të nënshkruajë apo ka marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe, duke ndikuar në rritjen e mëtejshme të volumit tregtar me vendet e rajonit, që prej disa vitesh tashmë ka shënuar rritje të ndjeshme. Nga praktika, sidomos për bizneset tona që eksportojnë frutaperime, por edhe më gjerë, ka lindur nevoja për lehtësimin e procedurave të kontrollit nga autoritetet përgjegjëse për sigurinë ushqimore në pikat e inspektimit kufitar, ose siç njihen shkurtimisht PIK, në mënyrë që lëvizja e produkteve të bëhet në një kohë sa më të shkurtër, duke besuar se kjo sjell incentivim sidomos për bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat do të kenë të mundur më lehtë arritjen e tregjeve rajonale.

Është fakt i njohur tashmë nga të gjithë që eksportet tona bujqësore kanë njohur rritje eksponenciale, duke kaluar edhe gjatë vitit 2021 mbi 400 milionë dollarë, e realizuar kjo në mbi rreth 20 mijë ngarkesa që kanë kaluar përmes pikave tona kufitare, pjesa më e madhe, sigurisht, ka qenë drejt vendeve të BE-së, por edhe në vendet e rajonit. Pra, siç e thamë, kemi një rritje të ndjeshme dhe llogaritet se rreth 25%- 30% e këtyre ngarkesave shkojnë drejt vendeve të rajonit. Si nismëtar, sigurisht që kam shumë për të thënë, por meqë jemi edhe në fund të seancës, më lejoni të shprehem shkurtimisht dhe të sqaroj për qytetarët disa nga ndryshimet më thelbësore që propozoj dhe që parashikohen në këtë projektligj. Kështu, në projektligjin për ushqimin parashikohet hartimi dhe miratimi i një strategjie për sigurinë ushqimore, në kuadër të përmbushjes së detyrimit për rritjen e një standardi më të lartë të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve. Kontrolli i përputhshmërisë së dokumentacionit shoqërues të ngarkesave të ushqimeve të importuara, me kërkesat e legjislacionit shqiptar, i cili kryhet në pikat e inspektimit kufitar nga inspektori i institucionit përgjegjës të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshët, si dhe tarifa për marrjen e mostrave, në rast të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, do të kryhet sipas parashikimeve që përcaktohen në marrëveshje me tendenca lehtësuese.

Ndërsa në projektligjin për shërbimin veterinar, parashikohet, po ashtu, që në rastin e këtyre marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe kontrolli i ngarkesave të kafshëve, të materialit biologjik, të produkteve me origjinë shtazore, dhe produkteve mjekësore veterinare, të hiqen kontrollet e dyfishta në çdo pikë, duke shkurtuar si kohën e biznesit për të lëvruar produkte ushqimore sensitive, ashtu edhe duke sjellë përfitime për konsumatorin, i cili do të ketë mundësi të aksesojë në produkte më të freskëta. Shkurtimisht, dua të them edhe nja dy teknikalitete. Kështu, në Komisionin e Regjistrimit të Produkteve Mjekësore Veterinare shtohet një anëtar nga autoriteti kompetent i

veterinarisë, si një element shtesë për garantimin e kompetencës së kontrollit, si dhe humbjen e menjëhershme të vlefshmërisë së certifikatës së tregtimit të produkteve mjekësore veterinarë, me mbarimin e kësaj vlefshmërie si në një nga vendet e BE-së ashtu edhe nga EMA, si dhe detyrimi që mbajtësi i certifikatës të njoftojë menjëherë strukturën përgjegjëse për veterinarinë dhe autoritetin kompetent. Çregjistrimi i certifikatave për tregtim të produkteve mjekësore veterinarë të regjistruara për produkte që nuk kanë certifikatë tregtimi, nga një nga vendet e Bashkimit Europian apo që nuk është e lëshuar nga EMA, ose janë regjistruar në kundërshtim me ligjin. Më lejoni të theksoj edhe një herë, në mënyrë të veçantë, si elementin më të rëndësishëm, çështjen e sigurisë ushqimore, sepse gjatë diskutimeve që patëm në komision, si dhe gjatë shqyrtimit nën për nën të këtyre dy projektligjeve, u ngrit shqetësimi i sigurisë ushqimore, ndaj dua ta risjell edhe një herë në vëmendje dhe të sqaroj sërish, këto ndryshime në asnjë moment nuk cenojnë sigurinë ushqimore. Përfitoj nga rasti për të falënderuar kolegët e pozitës për mbështetjen, por edhe ata të opozitës që, edhe pse nuk i mbështetën dhe nuk i votuan këto ndryshime me diskutimet dhe vërejtjet e tyre, më ndihmuan për formulime më të sakta! Dhe pikërisht këto ndryshime do të na imponojnë rritjen më cilësore dhe sasiore të kontroleve dhe analizave që bëhen nga laboratorët tanë sot.

Nga krahu tjetër, duke u njohur me marrëveshjet si ente që prodhojnë dokumente të certifikuara ndërkombëtarisht, do të sjellin një hapje të tregut rajonal për produktet tona blegtorale, i cili sot rezulton ende i mbyllur. Më lejoni, njëkohësisht, të sqaroj për ju dhe qytetarët, se ngarkesat me kafshë të gjalla dhe produkte shtazore, si sot, edhe mbas këtyre ndryshimeve, do të vazhdojnë të importohen nga zona, rajone dhe vende, të cilat kanë një situatë epizootike të pastër, të përcaktuar dhe të garantuar nga Organizata Botërore e Shëndetit të Kafshëve (OIE-ja), që shoqërohen me certifikatë veterinarë, sipas kërkesave të OIE-së dhe modelit të dakordësuar midis vendeve. Ky është kushti bazë i garantimit të shkëmbimeve tregtare konform parametrave të sigurisë ushqimore. Në rast moskonformiteti me dokumentacionin, kryesisht certifikatën veterinarë, ngarkesa kthehet mbrapsht nga pika e kontrollit kufitar dhe ky rregull nuk cenohet as me këto ndryshime. E shikoj me vend të ritheksoj edhe një herë, që amendamentet do të krijojnë detyrime për hartimin e një strategjie për sigurinë ushqimore, e cila duhet të adresojë në terma afatgjatë çështje që lidhen me të dhe që impaktojnë konsumatorin në radhë të parë, pasi do të garantojë një nivel të lartë të mbrojtës së shëndetit të qytetarëve. Duke gjykuar se propozimet për ndryshime në të dyja ligjet e lartpërmendura, do të lehtësojnë dhe ndihmojnë operatorët e biznesit, duke sjellë lehtësim të procedurave në pikat e kalimit kufitar, ulje të ndjeshme të kohës së përpunimit dhe kostove, pa prekur, përkundrazi duke rritur sigurinë ushqimore, ju ftoj t'i miratojmë ato. Faleminderit!